



Na ndihmoni për t'i njohur më mirë pacientët tanë

Kur dimë racën dhe përkatësinë tuaj etnike, ne mësojmë më shumë për kulturën dhe gjuhën tuaj. Kjo na ndihmon për t'ju njohur më mirë dhe për të përmirësuar kujdesin shëndetësor që u japim gjithë pacientëve. Duke filluar nga janari 2007, ne do të kërkojmë informacion në lidhje me racën dhe përkatësinë etnike të gjithë pacientëve.

Cila është përkatësia juaj etnike?

Përkatësia etnike i referohet prejardhjes, trashëgimisë, kulturës, paraardhësve ose ndonjëherë edhe vendit nga keni ardhur. Lutemi na tregoni nëse jeni haitian, vietnamez, brazilian, etj.

Jeni hispanik, latin apo spanjoll?

Mund të jeni hispanik, latin apo spanjoll ose familja juaj mund të ketë ardhur nga ndonjë vend i Amerikës Latine apo ndonjë vend tjetër spanjisht-folës. Lutemi na informoni nëse e cilësoni veten si hispanik, latin apo spanjoll.

Cila është raca juaj?

Raca është grupi ose grupet me të cilët ju identifikoheni në bazë të karakteristikave fizike të përbashkëta ose origjinës së ngjashme sociale apo gjeografike. Lutemi na njoftoni nëse jeni aziatik, zezak, i bardhë, etj.

Shembuj:

Unë quhem Xhon. I përkas racës aziatike dhe etnicitetit bangladeshas.
Unë quhem Klaudia. I përkas racës së zezë dhe etnicitetit haitian dhe xhamaikan.
Unë quhem Ronaldo. I përkas racës së bardhë e të zezë dhe etnicitetit brazilian.
Unë quhem Pat. I përkas racës së zezë dhe etnicitetit afrikano-amerikan.
Unë quhem Kris. I përkas racës së bardhë dhe etnicitetit italian dhe amerikan.



Duke i njohur më mirë pacientët tanë, ne ju sigurojmë atyre shërbim më të mirë

Qëllimi ynë është të plotësojmë nevojat e të gjithë pacientëve të cilëve u shërbejmë, Studimet kanë treguar se ekzistojnë ndryshime në shëndetin e grupeve racore dhe etnike. Ne nuk e dimë se cilat janë shkaqet e këtyre ndryshimeve dhe prandaj duam t'i mësojmë ato. Ne mund t'i plotësojmë më mirë nevojat e komuniteteve të cilëve ju shërbejmë në qoftë se dimë më shumë për racën, etnicitetin, kulturën dhe gjuhën e pacientëve tanë. Ky informacion do të përdoret vetëm për të siguruar kujdesin e duhur të cilësisë më të lartë.



**Përmirësojmë
shëndetin e
TË GJITHËVE**

Insert hospital
logo here

Albanian